



## SYLLABUS I LËNDËS “SHKRIM AKADEMIK”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Shkrim akademik
Programi:	Menaxhment Ndërkombëtar
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative (O)
Viti i studimeve:	Viti 2 / Semestri 2
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. assoc. dr. Shukri MAXHUNI
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:shukri.maxhuni@uni-prizren.com">shukri.maxhuni@uni-prizren.com</a> ; shumax4@hotmail.com +383 48 660232
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Lënda Shkrimi Akademik synon që t'u japë studentëve njohuritë themelore mbi mënyrat dhe metodat e shkrimit të punimve akademike me stilet ndërkombëtare. Në qendër të këtij kursi do të jetë pajisja e studentëve me njohuritë e duhura për të përballuar me sukses të gjitha kërkesat akademike të studimeve universitare në mënyrë që ata të mësojnë të shprehën qartë, të organizojnë si duhet mendimet e tyre, si dhe të nxisë tek ata mendimin kritik dhe gjykimin shkencor. Gjatë zhvillimit të kësaj lënde studentët do të njihen me llojet e stileve të shkrimeve dhe burimeve që përdoren në punën kërkimore si dhe me rrugët që ndiqen për të mbledhur gjithë materialin e nevojshëm që shërben në shkrimin e punimeve akademike. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu edhe metodat e analizimit dhe leximit të burimeve primare dhe sekondare në mënyrë që t'i përdorin ato sa më mirë gjatë dhe pas studimeve bachelor. Studentët do të mësojnë gjithashtu kriteret që përdoren për strukturimin e punimit dhe përdorimit me efikasitet të materialeve të grumbulluara prej tyre gjatë punës kërkimore.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>-Qëllimi kryesor i lëndës është të njohë studentët me konceptet bazë të komunikimit dhe të shkruarit akademik. Ky qëllim do të arrihet përmes detyrave të ndryshme praktike, leksioneve, diskutimeve, leximit të materialeve/librave të ndryshme, që mund të përfshijnë edhe një gazetë të përditshme.</li><li>-Studentët do të fitojnë shprehje të terminologji më të zakonshme që përdoret në të kuptuarit, të shprehurur dhe të shkruarit akademik.</li><li>-Studentët do të arrijnë të shkruajnë detyrat e ndryshme, që do të kenë gjatë viteve të shkollës së lartë, me një stil të përshtatshëm akademik.</li><li>-Që të forcoj më tej të menduarit kritik. Studentët do të inkurajohen të krijojnë perspektiva krahasuese dhe të përdorin</li></ul>

	të njejtat mjete dhe forma që përdorin edhe profesionistët në shkencat përkatëse.		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Studentët që kryejnë me sukses këtë kurs do të aftësohen të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikojnë qartë çështjen kërkimore.</li> <li>2. Të kuptojnë se si duhet shfrytëzuar në mënyrë efektive literaturën shkencore për të shkruar një shkrim akademik.</li> <li>3. Operacionalizojnë konceptet kryesore në kërkimin shkencor për të mundësuar matjet empirike.</li> <li>4. Të dijnë të formojnë kornizën konceptuale ku pasqyrohen raportet midis ndryshoreve të pavarura dhe atyre të vara.</li> <li>5. Hartojnë planin kërkimor të një studimi shkencor, duke përcaktuar njësinë, popullatën, listën referuese dhe mostrën e studimit.</li> <li>6. Analizojnë të dhënat dhe të formulojnë dhe testojnë hipotezat kryesore të studimit.</li> <li>7. Të jenë në gjendje të diskutojnë gjetjet kryesore shkencore që të dalin nga kërkimi shkencor në raport me propozicionet teorike në të cilat mbështetet studimi.</li> <li>8. Të jenë në gjendje të analizojnë dhe identifikojnë kontributin substancial, teorik dhe praktik të kërkimeve të tyre (të arsyetojnë dobinë që do të ketë entiteti profesional, shkencor dhe institucional nga përdorimi i gjetjeve shkencore).</li> </ol>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	3	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	4	2
Ushtrime në terren	1	3	3
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	4	4
Përgatitja përfundimtare për provim	0.5	10	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet ,etj	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>75 orë (6 ECTS)</b>



<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, luajtja e roleve, prezentimi i posterëve, vizitat në terren, kolokviume, raste studimi, provimi përfundimtar.
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%, Provimi i ndërmjetëm (kolokviumi): 10%, Puna seminarike: 10% Rasti studimor: 10%, Provimi final: 60%,
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Sylvian Barnet, Pat Bellanca, Marcia Stubbs: SHKRIMI AKADEMIK – A short Guide to college writing. Isp, Dita 2000. Tiranë</li><li>2. X.J.Kennedy, Dorothy M. Kennedy, Maria M. Futh: UDHËRREFYES I AVANCUAR I SHKRIMIT AKADEMIK – The Bedford Guide for Collegewreiterts, në nivelin Universitar. Dhjetor 2009, Tiranë.</li><li>3. Bernard Zeneli, Sonila Danaj: Shkrim Akademik, Cikël Leksionesh &amp; Përmbledhje artikujsh, Shtëpia botuese UFFO Press Tiranë.</li><li>4. Hoxha, Artan R. Shkrimi Akademik për studentët e lëndëve historike. (Leskion i pabotuar).</li><li>5. Eco, Umberto. Si të shkruajmë një punim diplome. (Tiranë: Dituria, 2005). Literatura plotësuese 1. Zeneli, Bernard. Shkrimi Akademik. (Tiranë: UFO, 2006).</li><li>6. Musai, Bardhyl. Të shkruajmë ese. (Tiranë: Pegi, 2004). 3. Nishku, Majlinda. Proçesi dhe shkrimet funksionale. (Tiranë: Pegi, 2004)</li><li>7. Shaban Demiraj, Gramatika e gjuhës shqipe, Fonetika Morfologjia. Enti i Teksteve dhe Mjeteve te Kosoves, Prishtine.</li><li>8. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e shqipërisë, 2008, Tiranë.</li></ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Prezentimi i lëndës. Çfarë është shkrimi akademik.	Sqarimi i marrjes së shenimeve ne leksione. Te shkruarit akademik.

		Procesi i te menduarit kritik.
<i>Java e dytë:</i>	Të shkruash për lexuesin.	Teknikat per mbledhjen e informacioneve: Burimet parësore Arkivi, katalogu dhe kerkimi i burimeve te para. Teknikat per nxjerrjen e informacioneve. Fillimin e procesit te krijimit akademik.
<i>Java e tretë:</i>	Fjalja.	Shenjat e pikesimit. Reregullat e drejtshkrimit ne shqip.
<i>Java e katërt:</i>	Fillimi i procesit krijues.	Fjalinë temë. Zhvillimin e paragrafit. Analiza e burimeve të dyta dhe marrëdhënia tekst–autor. Katalogjet dhe puna kërkimore në bibliotekë.
<i>Java e pestë:</i>	Procesi i të shkruarit akademik.	Lidhja shkrimtar – lexues. Çfarë kërkon lexuesi nga shkrimtari. Procesi i krijimit akademik. Të shkruarit të fjalisë “Tezë”. Përdorimi i shtypit. Rëndësia dhe kufizimet e tij. Struktura. Ndërtimi i esesë ose detyrës së kursit. Fjalja temë – organizimi i paragrafëve. -Shpërndarja e punimeve për student.
<i>Java e gjashtë:</i>	Stilet nderkombetare per citimin e referencave akademike dhe për shkrimin e bibliografisë, shkrime akademike.	Pse duhet të përmenden dhe citohen referencat. Çfarë është një stil "referencimi". Stilet: Harward, APA, Chicago, Wancouver. IEE(per kompjuter). Shkurtesa që mund të përdoren në citime Këshilla për të parandaluar plagjiaturën. Informacione shtesë në Internet në lidhje me format e referencimit.
<i>Java e shtatë:</i>	Përkufizimi. Nevoja për të përkufizuar.	Strategjitë e përkufizimit. Procesi i përkufizimit. Procesi i zbulimit. Projekti përfundimtar dhe përkufizimet. Rishikimi i përkufizimeve.
<i>Java e tetë:</i>	Kollequium.	The process of thinking.

	Struktura e argumentit.	
<i>Java e nëntë:</i>	Citimi. Perifrazimi. Përmbledhja.	Si t'i citosh burimet. Pse citohen. Format e perifrazimit. Mënyra e përmbledhjes. Kontrasti dhe krahasimi. Të shkruarit me më shumë se një burim ose me burime të bashkërenduara. Katër silet e shkrimit dhe citimit akademik.
<i>Java e dhjetë:</i>	Ndërtimi dhe llojet e eseve I. Metodologjia e nje shkrimi akademik.	Eseja kritike. Eseja problemore.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ndërtimi dhe llojet e eseve II. Recensimi. Provimi ese. Metodologjia e nje shkrimi akademik.	Studentet do të mësojnë për: -Recensa. -Provimi ese. Pyetje për diskutim dhe detyra.
		Studentet do të mësojnë për: -Gjetja dhe ngushtimi i temës. Analiza e burimeve të dyta dhe marrëdhënia tekst–autor. - Pyetje për diskutim dhe detyra.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Eseja kërkimore – shkencore/detyrat e kursit I. Metodologjia e nje shkrimi akademik.	Përdorimi dhe përcaktimi i burimeve kërkimore – shkencore. -Burimet parësore dhe dytësore. -Përgatitja e biografisë. Pyetje për diskutim dhe detyra.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Eseja kërkimore – shkencore/detyrat e kursit II. Metodologjia e nje shkrimi akademik.	Gjetja dhe ngushtimi i temës. Përdorimi dhe përcaktimi i burimeve kërkimore – shkencore. Burimet parësore dhe dytësore. Përgatitja e biografisë.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Përfundimi i esesë kërkimore shkencore.	Rishikimi i tezës, idesë kryesore. -Shkrimi i draftit. -Citimi, kreditimi, mirënjohja për burimet. -Mosrënja në plagjiaturë. -Shkrimi i projekti të përfundimtar. -Rishikimi gramatiko – formal. -Rishikimi nga kolegët. Shkrimi i 'Parathënies.



		<p>Shkrimi i ‘Hyrjes’.</p> <p>Punë seminari për një grup të nxënësve (2-3 studentë në grup maksimum) të lidhura me projektin kërkimor Prezantimi dhe reflektimi për temën e dhënë.</p>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Të shprehurit akademik.	<p>Prezantimet.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Prezantimi gojor i punimit.</li><li>-Komunikimi.</li><li>-Teknikat e të folurit në publik.</li><li>-Përdorimi i mjeteve elektronike.</li></ul> <p>Trupi i punimit dhe argumenti kryesor.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Prezentimi ne grup.</li></ul> <p>Si t’u përgjigjemi pyetjeve.</p> <p>Punë seminari për një grup të nxënësve (2-3 studentë në grup maksimum) të lidhura me projektin kërkimor Prezantimi dhe reflektimi për temën e dhënë.</p> <p>Pergatije per provim</p>
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<p>Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe në punë seminarike; Mbajtja e qetësisë në mësim, çkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj.</p>		